



Pranuar / Doretuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivery	29 - 12	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHK	7755/2023		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1363/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1363/2023 të datës 31.10.2023, të parashtruar nga grupi i ankuesve

..... kundër Vendimit të datës 04.10.2023 të Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1363/2023 e datës 31.10.2023 e parashtruar nga ankuesit

lidhur me pretendimin ankimor për *kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit*, nga muaji tetor 2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

II. Refuzohet pretendimi ankimor i ankuesve që në kompensimin e kërkuar të përfshihen edhe përqindjet e kompensimit 20%, 30% dhe 50% sipas normave më të favorshme në të cilën kanë punuar ankuesit nga muaji tetor 2022 e deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

III. Obligohet Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor 2022 e deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesit, të punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës në pozitën “Zyrtar i Lartë Grumbullim dhe Përpunim të Informatave” në Qendrën e Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me datë 31.10.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6795/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 04.10.2023 me shifër protokolli:79/2023 të Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill pretendojnë se Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 04.10.2023 nuk ka zbatuar në plotni Vendimin e Këshillit A.nr.600/2023 të datës 16.05.2023 përmes të cilit na u është njohur e drejta sikurse në pikën III të dispozitivit të të njëjtit vendimi: “*Obligohet-Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punë gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor deri në zbatimin e këtij vendimi*” kurse Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 04.10.2023 na e ka njohur vetëm të drejtën për shtesën mbi pagën bazë për punë gjatë kujdestarisë nga muaji tetor i vitit 2022, më kërkesën që Këshilli të obligoi që ankuesve t’ua paguaj diferencën e kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë, për punën e kujdestarisë, punën jashtë orarit , punë e natës, punën gjatë vikendit dhe punën gjatë festave zyrtare (duke përfshirë edhe përqindjet e kompesnimit 20%, 30% dhe 50% sipas normave më të favorshme në të cilën kanë punuar ankuesit) konform legjislacionit në fuqi nga muaji tetor 2022 e deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2023, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshillin e Sigurisë së Kosovës, ndërsa me datën 16.12.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6795/2023 e datës 31.10.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me autorizimet e bashkangjitura; Vendimin e Këshillit A.nr.600/2023 të datës 16.05.2023; Vendimin e datës 04.10.2023 të Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Tabelën Nr.1, e ararit të punës së kujdestarisë; Tabelën Nr.2, e orarit të punës së kujdestarisë; E-mailin e ankuesit të datës 11.10.2023 të dërguar nga ankuesi T.H për Sh.Sh etj me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e ankuesit të datës 12.10.2023 të dërguar nga ankuesi T.H për Këshillin; E-mailin e ankuesve të datës 31.10.2023 dërguar në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.011.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 22.11.2023; Akt emërimit e datës 01.08.2017; Akt emërimit e datës 31.07.2023; Akt emërimit e datës 19.01.2012 për M.K; Akt emërimit e datës 19.01.2012 për R.L; Akt emërimit e datës 30.04.2014; Akt emërimit e datës 19.01.2012 për T.M; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankuesve; Shkresën e datës 02.12.2015 me shifër:5353; Njoftimin e datës 04.10.2023; Njoftimin sqarues të datës 30.05.2023 përcjell nga F.I për M.G; E-mailin datës 28.08.2023 dërguar nga A.T për K.K etj me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 26.09.2023 dërguar nga V.G për F.T me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 05.10.2023 dërguar nga K.K për F.I; Shkresa me fondin e orëve për muajt, shkurt deri në shtator 2023; Shkresa me fondin e orëve për muajt, tetor 2022 deri në janar 2023; Shkresa me përmbajtjet tabelore për kompensimet sipas Vendimit të datës 01.10.2023 ndërlidhur me zbatimin e Vendimit të Këshillit A.nr.600/2023.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore ta ankuesve ka konstatuar se Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 04.10.2023 nuk ka zbatuar në plotni Vendimin e Këshillit A.nr.600/2023 të datës 16.05.2023 pasi që përmes pikën III të dispozitivit të të njëjtit vendimi, citoj: "**Obligohet Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punë gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor deri në zbatimin e këtij vendimi**", kurse Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 04.10.2023 sipas pikës 2 të dispozitivit ua ka njohur ankuesve vetëm të drejtën, citoj: "**2. Për ankuesit do të behët kompesnimi i shtesave mbi pagën bazë për punën gjatë kujdestarisë (në formë retrokative nga muaji tetor 2022).**", ndërsa në pikën 1 të dispozitivit të vendimit të kontestuar përcaktohet se, citoj: "**1. Zbatohet vendimi A.nr.600/2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**".

Duke marrë për bazë nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "**Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.**", Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 04.10.2023 ka zbatuar vetëm pjesërisht vendimin e Këshillit A.nr.600/2023 të datës 16.05.2023, prandaj mbi këtë bazë meqenëse kjo çështje ankimore është vendosur dhe se vendimi i Këshillit është bërë i ekzekutueshëm, ankuesve parashtruar të kësaj ankuese u aprovohet pjesërisht ankesa e tyre e datës 31.10.2023 lidhur me pretendimin ankimor lidhur me kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor 2022 deri në zbatimin e këtij vendimi, pasi që kompensimi i pagës shtesë mbi pagën bazë për punën gjatë kujdestarisë vetëm se u është njohur përmes Vendimit të datës 01.10.2023 të Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Lidhur me pretendimin ankimore të ankuesve që në kompensimin e kërkuar të përfshihen edhe përqindjet e kompensimit 20%, 30% dhe 50% sipas normave më të favorshme në të cilën kanë punuar ankuesit nga muaji tetor 2022 e deri në nxjerrjen e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se ky pretendim ankimor në këtë fazë të shqyrtimit ankimor nuk mund të aprovohet, pasi që ankuesit në të njëjtën kohe me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 31.10.2023 thirren në moszbatimin e vendimit të Këshillit A.nr.600/2023 të datës 16.05.2023, ndërsa i kanë zgjeruar pretendimet ankimore sikurse kërkesën për përqindjet e kompensimit 20%, 30% dhe 50% sipas normave më të favorshme në të cilën kanë punuar ankuesit e të cilat kërkesa realisht nuk kanë qenë të paraqitura me rastin e parashtrimit të ankesës së tyre të datës 02.12.2022, prandaj përderisa Këshilli lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve për kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punë gjatë kujdestarisë, punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor 2022 ka vendosur paraprakisht nuk mundet të vendos ndryshe përderisa ankuesit thirren për zbatimin e vendimit të Këshillit A.nr.600/2023 i cili është bërë i ekzekutueshëm, e që për rrjedhojë palët në procedurë kanë mundur të zgjerojnë pretendimet ankimore ose të bëjnë plotësim të ankesës deri në fazën e vendimmarrjes me Vendimin e Këshillit A.nr.600/2023, apo kundër të njëjtit kanë mundur të hapin konflikt administrativ sipas këshillës së dhënë juridike, prandaj Kolegji i Këshillit konstatoi se refuzohet sikurse në dispozitivin e këtij vendimi pretendimi ankimore i ankuesve që në kompensimin



e kërkuar të përfshihen edhe përqindjet e kompensimit 20%, 30% dhe 50% sipas normave më të favorshme në të cilën kanë punuar ankuesit nga muaji tetor 2022 e deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

Prandaj nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi ashtu që ankesa e ankuesve e datës 31.10.2023 aprovohet pjesërisht si e bazuar, gjegjësisht aprovohet pretendimi ankimor i ankuesve lidhur me kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë për punën jashtë orarit, punën e natës, punën gjatë vikendeve dhe punës gjatë festave zyrtare për ankuesit, nga muaji tetor 2022 deri në zbatimin e këtij vendimi, pasi që kompensimi i pagës shtesë mbi pagën bazë për punën gjatë kujdestarisë vetëm se u është njohur përmes Vendimit të datës 01.10.2023 Zv. Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ndërsa refuzohet pretendimi ankimor i pretendimi ankimore i ankuesve që në kompensimin e kërkuar të përfshihen edhe përqindjet e kompensimit 20%, 30% dhe 50% sipas normave më të favorshme në të cilën kanë punuar ankuesit nga muaji tetor 2022 e deri në nxjerrjen e këtij vendimi.


Kolegji i Këshillit thekson faktin se Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit afateve të përcaktuara kohore sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, në të kundërtën Këshilli vepron konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku me nenin 24 paragrafi 1 përcaktohet se: "Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit."

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1363/2023

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin e Sigurisë të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK- së;

